



**OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT**  
**DREJTORIA E PROKURIMEVE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)**

**Drejtuar: OE “NOVAMAT” sh.p.k me NIPT K81615002O**

Adresa: Tiranë Rruga "Ismail Qemali", Pallati Samos Tower, kt.8, Nr 41,  
Njësia Nr.05

**Procedura e prokurimit:** “Procedurë e hapur” me mjete elektronike – Mallra.

**Numri i referencës së procedures:** REF-93785-01-25-2024

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** “Rinovimi i kompletit (setit) të aparateve për matjen e pajisjeve primare dhe transformatorëve të fuqisë si dhe trajnimi i personelit të DSHMT”.

**Publikimet e mëparshme (nëse është rasti):** Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 4, datë 29.01.2024.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. OE “ARGUS POWER” sh.p.k. me NIPT L41707026U**

Vlera 25,801,970 (njëzet e pesë milion e tetëqind e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) Lekë pa TVSH.

**2. OE “NOVAMAT” sh.p.k. me NIPT K81615002O**

Vlera 27,850,000 (njëzet e shtatë milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:**

**1. OE “ARGUS POWER” sh.p.k., me NIPT L41707026U, për arsye se:**

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.4, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi produktet e ofruara nuk përmbushin specifikimet teknike të kërkuara në Dokumentet e Tenderit, si më poshtë:

a) Për zërin: “Aparaturë komplete multifunksionale për matjen e auto dhe transformatorëve të fuqisë trefazor e pajisur edhe me transformator tensionin për teste në tension të rritur”, ka mangësi thelbësore, si vijon:

Është kërkuar	Është paraqitur
<p>Kjo aparaturë në specifikimet teknike të hartuara nga ana e OST sh.a. ka pasur si objektiv kryesor <b>“matjen e auto dhe transformatorëve të fuqisë trefazor”</b></p> <p>“Aparatura duhet të jetë e projektuar sipas një vizatimi kompakt dhe të fuqishëm <u>të pajisur me tre burime të integruara duke na mundësuar të kryejmë matje me saktësi të lartë në një kohë me të shkurtër, krahasuar me aparaturat e tjera</u>, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>&gt; <u>Raporti i spirave të transformatorit 3fazor me 400 V L-L;</u></li> <li>&gt; <u>Rezistenca e pëshpjelljellës 3-fazore me rrymë &gt;30 A DC;</u></li> <li>&gt; <u>Tension të qarkut të shkurtër 3-fazor / reaktanca e rrjedhjes 3-fazore,</u> etj.”</li> </ul>	<p>Aparatura e ofruar nga Operatori Ekonomik, <b><u>ka një dallim thelbësor, i mungojnë tre burimet e integruara</u></b> dhe nuk kryen matje tre fazore.</p> <p>Si rrjedhojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kemi kufizim drastik të rrymave të matjeve kur kryhen matje me pajisjen ofruar deri 16 A DC, <b><u>nga &gt;30 A DC të kërkuar në specifikime;</u></b></li> <li>- Ul sigurinë e përdoruesve, pasi nga vendosja e kabllave nga aparatura direkt në auto apo transformator trefazor, siç është kërkuar në Specifikimet Teknike, duhet të kemi kabllimin nga aparatura bazë e ofruar në pajisje ndërmjetëse dhe më pas nga pajisje ndërmjeste auto apo transformator tre fazor;</li> <li>- Skema është shumë më e thjeshtë në rastin e specifikuar, vetëm me kabllime aparature - transformator, sesa në rastin me pajisje ndërmjetëse të ofruar nga OE</li> </ul>
<p><u>“Programi i menaxhimit dhe asistimit të testeve” si dhe benefitet që siguron ky program, sipas përshkrimeve përkatëse në Specifikimeve Teknike.</u></p>	<p>Nuk ka të dhëna</p>

<p><u>Program i cili shërben për asitim dhe thjeshtëzimin e kryerjes së testeve dhe programin e lehte të tyre paraprakisht, gjenerimin automatik të raportit të testimeve pas kryerjes së tyre dhe asitencën sipas standarteve të rezultateve, krijimin automatikisht të një arshive e cila mund të aksesohet në çdo kohë, etj.</u></p>	
<p>Kerkesat e sistemit për te suportuar programin e menaxhimit të testeve (matjeve) dhe asistimit të tyre:</p> <p>Kërkesat e sistemit:</p> <p>Sitemi i operimit: <b>Windows 10™, 64-bit ose më i fundit;</b></p> <p>CPU: <b>Sistem me shumë bërthama me 2 GHz ose më i shpejtë (Multicore system with 2 GHz or faster);</b></p> <p>RAM: <b>≥8 GB;</b></p> <p>Hard disk: <b>≥5 GB</b> të hapësirës në dispozicion;</p> <p>Storage device: DVD-ROM drive;</p> <p>Graphics adapter: Super VGA (1280×768) ose përshtatës dhe monitor video me rezolucion më të lartë (or higher-resolution video adapter and monitor);</p> <p>Ndërfaqja (Interface): Internet (Ethernet) NIC;</p> <p>Programet e instaluar (Installed software): Microsoft Office® 365, Office® 2019, Office® 2016 or Office® 2013.</p>	<p>Nuk ka të dhëna.</p>
<p>Ekzistencën e aplikacionit për instalimin e programit të menaxhimit të matjeve në smartfone që bën të mundur kontrollin e skemës dhe komandimin në distancë, për stakim në rast të një emergjence për personelin që kryen testimin apo pajisjen që testohet.</p>	<p>Nuk ka të dhëna.</p>
<p>E gjithë pajisja duhet të jetë e lehtë në përdorim edhe nga një personel i vetëm në terren dhe si e tillë të mos e kaloj një peshë prej rreth &lt;21 kg</p>	<p>Pajisja e ofruar është rreth 30 kg</p>

b) Për zërin: “Aparaturë për Analizën me Përgjigje me Frekuencë (FRA) të autove dhe transformatorëve të fuqisë”, ka mangësi thelbësore, si vijon:

Është kërkuar	Është paraqitur
<p>Në aparaturën e specifikuar është kërkuar kryerja e tetimeve nëpërmjet një PC-je jo të integruar ne te cilen eshte instaluar programin e menaxhimit të testeve. Kjo siguron:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Një përgatitje më të lehtësuar paraprake, që në zyrë, për shembull, nëpërmjet programi të menaxhimit të testeve, të punimit që do të kryhet duke futur edhe të dhënat individuale të auto apo transformatorit që do të testohet;</li> <li>- Kryerjen e testimeve nëpërmjet programi të menaxhimit dhe asistimit të testeve, me të gjithë benefitet që siguron ky program;</li> <li>- Gjenerimin automatik dhe përgatitjen dhe e raportit, krijimin automatikisht të një archive e cila mund të aksesohet në çdo kohë, vendosjen e logove të kompanisë, printimin e raportit teknik direkt nga PC në printer, etj.</li> </ul>	<p>Në varjantin e ofruar kemi inkorporim të PC në aparaturë që është me një ekran me prekje, që nuk i ka lehtësitë e mësipërme, dhe materjali i gjeneruar pas testimit merret nga aparatura me USB për përpunim të mëtejshëm në një PC dhe printim.</p>
<p>Kerkesat e sistemit per te suportuar programin e menaxhimit të testeve (matjeve) dhe asistimit të tyre:</p> <p>Kërkesat e sistemit:</p> <p>Sitemi i operimit: <b>Windows 10™, 64-bit ose më i fundit;</b></p> <p>CPU: <b>Sistem me shumë bërthama me 2 GHz ose më i shpejtë (Multicore system with 2 GHz or faster);</b></p> <p>RAM: <b>≥8 GB;</b></p> <p>Hard disk: <b>≥5 GB</b> të hapësirës në dispozicion;</p> <p>Storage device: DVD-ROM drive;</p> <p>Graphics adapter: Super VGA (1280×768) ose përshtatës dhe monitor video me rezolucion më të lartë (or higher-resolution video adapter and monitor);</p>	<p>Sitemi i operimit: “Windows embedded”/ Windows® based;</p> <p>Memorja: 1000 regjistrime në memorie të brendshme, Ruajtja e jashtme në USB;</p>

Ndërfaqja (Interface): Internet (Ethernet) NIC; Programet e instaluar (Installed software): Microsoft Office® 365, Office® 2019, Office® 2016 or Office® 2013.	
Ekzistencën e aplikacionit për instalimin e programit të menaxhimit të matjeve në smartfone që bën të mundur kontrollin e skemës dhe komandimin në distancë, për stakim në rast të një emergjence për personelin që kryen testimin apo pajisjen që testohet.	
Diapazoni (brezi) i frekuencave: 1 Hz ... 30 MHz	Diapazoni (brezi) i frekuencave: 0.1 Hz ... 25 MHz
Lagështia relative: 20 % ---95 %, pa kondensim;	Lagështia relative: <90%, pa kondensim
Aksesorë plotësues, si më poshtë:  <ul style="list-style-type: none"> <li>- edhe shiritat e tokzimit, morseteritë, etj., për izolatorët e tensioneve të ulta (të shkurtër);</li> <li>- të gjithë aksesorët për testimin e shpejtë me një çantë transportimi.</li> </ul>	Nuk ka të dhëna

c) Për zërin: “Aparatura për matjen e temperaturave të kontakteve dhe analizën me imazh termik të auto dhe transformatorëve dhe pikave të nxehta në pajisjet e tjera primare”, ka mangësi thelbësore, si vijon:

<b>Është kërkuar</b>	<b>Është paraqitur</b>
Ekрани i aparatures: $\geq 3,45$	Ekрани i aparatures: 2.2 inch
Rezolucioni i frared: $\geq 630 \times \geq 470$ ( $\geq 296100$ piksel)	Rezolucioni i frared: $32 \times 31$ (992 piksel)
Gama e matjes së temperaturës : nga $\leq -19$ °C deri në $\geq +999$ °C	Gama e matjes së temperaturës : -20°C deri në +300 °C
Ndjeshmëria termike: $\leq 0,052$ °C ( $\leq 50$ mK)	Ndjeshmëria termike: $\leq 150$ mK
Kamera dixhitale e integruar $\geq 4.8$ MP te kerkuar	Kamera vizuale 48608 piksel
Kamera të ketë disa opsione me kapacitete të gjëra memorie, si: memorie flash e brendshme 4 GB, kartë memorie micro SD e lëvizshme 4 GB, aftësia e shkarkimit në USB,	Memorja: Kartë memorie Micro SD, ruan deri në 6000 imazhe, 4 GB të dhëna
Baterite: Dy bateri inteligjente me jon litium me ekran(ekspozim) LED me disa tregues të nivelit të	Baterite: Bateria (e vendosur): 18500 3,7 V 1400 mAh Li-Ion

karikimit	
Zmadhimi dixhital: $\geq 2x$ dhe $\geq 4x$	Nuk ka te dhena
Të ketë tregues lazer (rreze treguese)	Nuk ka te dhena
Të ketë dritë LED (“elektrik”) ndriçues	Nuk ka te dhena
Të ketë matës të distancës me lazer, të llogarisë distancën nga objektivi për imazhe të fokusuara saktësisht dhe të shfaqë distancën në ekran	Nuk ka te dhena
Kamera të sigurojë regjistrim të videos dhe formatet standard dhe radiometrik	Nuk ka te dhena
Të lejojë regjistrimin e shënim zanor gjatë matjes, koha maksimale e regjistrimit $\geq 58$ sekonda për imazh	Nuk ka te dhena
Karikues AC me energji, për furnizim e baterive, të përfshirë (100 V AC në 240 V AC, 50/60 Hz)	Nuk ka te dhena
Kamera të ketë lidhje me valë (Wireless) interneti për PC, Android™ 4.3 e lart dhe WiFi në LAN (kur disponohet)	Nuk ka te dhena

d) Për zërin: “Trajnim për specialistët e DSHMT për pajisjet e reja për matje pajisjesh primare dhe sekondare”, ka mangësi thelbësore, si vijon:

<b>Është kërkuar</b>	<b>Është paraqitur</b>
<p>“Laboratorët e trajnimit të përmbajnë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Objekte reale të testimit si: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Transformator fuqie tre fazor me rregullator tensioni në ngarkesë;</li> <li>- Transformator rryme dhe tensioni;</li> <li>- Çelës tre fazor fuqije bashkë me panelin përkatës të komandimit, etj.</li> </ul> </li> <li>2. Të gjithë aparaturat e përfshira në këto specifikime trajnimi të jenë pjesë e laboratorit ku do të kryhet trajnimi;”</li> </ol>	Nuk ka te dhena

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE “NOVAMAT” sh.p.k., me NIPT K816150020**, Adresa: Tiranë Rruga "Ismail Qemali", Pallati Samos Tower, kt.8, Nr 41, Njësia Nr.05, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **27,850,000 (njëzet e shtatë milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH**, është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.